



## NË KËTË NUMËR:

- Sektori i mbeturinave në fokus të mbështetjes nga donatorët
- Formohet Departamenti për Krime Mjedisore
- Mbledhja e Konferencës së Palëve për Konventën e Diversitetit Biologjik
- Kosova në raportin për rrjedhën e të dhënave në Agjencinë Evropiane të Mjedisit
- ProGEO-Kosova anëtare e ProGEO-Evropa
- Uji si burim i konfliktit
- Të dhëna të reja për biodiversitetin e globit

*I nderuari lexues,*

*Në prag të këtij fundviti, si dhuratë për lexuesit dhe dashamirësit e mjedisit, Buletini Mjedisor ju sjell edhe një numër. Gjatë vitit 2012 përmes Buletinit Mjedisor kemi munduar t'u informojmë për ngjarjet, arritjet dhe përpjekjet më të rëndësishme në sektorin e mbrojtjes së mjedisit që kanë ndodhur gjatë këtij viti.*

*Ne do të bëjmë përpjekje që në të njëjtën frymë të vazhdojmë edhe vitin tjetër. Edhe në këtë numër, Buletini Mjedisor i mbetet besnik formatit të temave të përzgjedhura dhe informacioneve të ofruara që prekin*

*ngjarje dhe aktivitete nga grupe dhe institucione të ndryshme. Me këtë rast, falënderojmë edhe njëherë të gjithë ata që kontribuan dhe ndihmuan në publikimin e Buletinit Mjedisor përmes informacioneve dhe temave të ofruara dhe i ftojme dhe i inkurajojmë për forcimin e këtij bashkëpunimi edhe në vitin e ri.*

*Urojmë që viti i ri 2013, të jetë vit i përpjekjeve, angazhimeve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e gjendjes së tij.*

**Ekipi Redaktues**

## SEKTORI I MBETURINAVE NË FOKUS TË MBËSHTETJES NGA DONATORËT



Menaxhimi i mbeturinave, vazhdon të mbetet një prej problemeve më të mëdha mjedisore në Kosovë. Duke u nisur nga kjo, një pjesë e madhe e mbështetjes së donatorëve është e orientuar në përmirësimin e gjendjes në këtë sektor. Kështu, si pjesë e projektit të implementuar nga Agjensioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) për ngritjen e kapaciteteve të menaxhimit të mbeturinave të ngurta, Qeveria Japoneze ka dhuruar 43 kamionëve për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave

urbane, 33 nga të cilët për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave Ekoregjionit në Prizren, ndërsa 10 për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave Pastrimi në Prishtinë. Ndërsa, Qeveria Norvegjeze përmes ambasadorit të saj në Kosovë, Jan Braathu, ka shprehur gatishmërinë për furnizimin e komunave të Kosovës me rreth 1000 kontejnerë të mbeturinave. Kontejnerët do t'u dhurohen komunave si pjesë e përkrahjes për menaxhimin më efikas të mbeturinave urbane.

Në anën tjetër në kuadër të projektit të financuar nga Banka Botërore për rehabilitimin e dheut rreth hapësirave të KEK'ut, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka nënshkruar marrëveshje me Suedinë dhe Belgjikën për transferimin e këtyre materive të rrezikshme për trajtim në këto vende. I gjithë projekti parasheh transferimin e rreth 600 ton materie të rrezikshme të llojit të kantranit, nga ish fabrika e gasifikimit në KEK. Mbeturinat e rrezikshme paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve dhe mjedisit, ndërkohë që Kosova ende nuk ka infrastrukturën për asgjësimin e tyre. Projekti i Bankës Botërore parasheh që asgjësimi i materieve të rrezikshme të bëhet në fabrika të akredituara dhe sipas direktivave të BE-së për menaxhimin e këtyre mbeturinave.

**INFORMATA TË PËRMBLEDHURA**

Sektori i Energjisë prodhon rreth 82% të emetimit të përgjithshëm nacional të gazeve serrë në Kosovë.

Një person brenda ditës gjeneron mesatarisht 1.6 kg mbeturina, ndër-kohë që në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave janë të përfshirë rreth gjysma e popullsisë së Kosovës (47%).

Sa i përket ofrimit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, regjioni i Prishtinës ka mbulueshmëri më të mirë me 57% të popullsisë dhe i Ferizajt me 51%, ndërsa regjioni i Mitrovicës me 31% dhe ai i Prizrenit me 40% karakterizohen me mbulueshmëri më të ulët.

Për shkak të pjerërtësisë së terrenit Kosova për çdo vjet humb përgjithmonë rreth 1000 ha të tokës nga erozioni. Ndërkohë që vetëm 15% të tokave konsiderohen si toka të mira, 29% toka me cilësi mesatare dhe më tepër se gjysma (56%) konsiderohen si toka me cilësi të dobët.

**FORMOHET DEPARTAMENTI PËR KRIME MJEDISORE**

Në kuadër të përpjekjeve për forcimin kapaciteteve të institucioneve për menaxhimin e mjedisit, në kuadër të Policisë së Kosovës është formuar Departamenti për Krime Mjedisore. Formimi i këtij Departamenti ka ardhur me iniciativë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me përkrahjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka për qëllim zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit. Ky Departament do të trajtojë ekskluzivisht veprimet e kundërligjore ndaj mjedisit, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Puna për zhvillimin e institucioneve kosovare, në këtë drejtim nuk

ka të bëjë thjesht vetëm me përgatitjen e vendit për zbatimin e Konventës Evropiane për Krimin Mjedisor, por më shumë për të adresuar nevojat në rritje, me të cilat përballen mjedisi dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e tij. Kjo kërkon përmirësim të zbatimit të ligjeve për mjedisin, duke siguruar mbështetje për identifikimin dhe ndjekjen e krimit të mjedisit. Krimi mjedisor është shndërruar kohët e fundit në një shqetësim global, si një veprimtari në rritje që shquhet si me llojshmëri dhe veprave penale ashtu edhe me ndërlikueshmëri të tyre. Që nga viti 1972, kur u mbajt Konferenca

e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Human në Stokholm të Suedisë, qeveritë e shumë vendeve të botës, në kuadrin e ndërmarrjes së politikave të përgjithshme kombëtare, kanë përgatitur strategji dhe plane në luftën kundër krimit mjedisor, duke synuar marrjen dhe zbatimin e masave institucionale dhe legjislative brenda juridiksioneve të tyre kombëtare, pa cenuar apo dëmtuar mjedisin e shteteve të tjera. Sot, në botë vepronë aktivisht mjaft organizata ndërkombëtare, rajonale e globale, të tilla si INTERPOL, Agjencia e Hetimit Mjedisor, etj, të cilat ndërmarrin nisma dhe bashkëpunime për mbrojtjen e mjedisit në botë.

**MBLEDHJA E KONFERENCËS SË PALËVE PËR KONVENTËN MBI DIVERSITETIN BIOLOGJIK**



Mbledhja e Njëmbëdhjetë e Konferencës së Palëve (KP-11) për Konventën mbi Diversitetin Biologjik (KDB) u mbajt nga 8 deri më 9 tetor 2012, në Hyderabad, Indi.

Konferenca e Palëve është organ qeverisës i Konventës, i cili nxit implementimin e Konventës me anë të vendime që i merr në mbledhjet e veta periodike.

Në mbledhje dhe ngjarjet zyrtare anësore morën pjesë përafërsisht 14,000 delegatë që përfaqësojnë Palët dhe qeveritë e tjera, organet e KB-së, organizatat ndërqeveritare, joqeveritare, organizatat vendase dhe të komunitetit lokal, akademikët dhe sektorin privat.

Kjo mbledhje u mbajt gjatë

Dekadës të Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin (UNDB) siç u shpall nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 65/161. Dekada e Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin paraqet mbështetjen dhe stimulon implementimin e synimeve të Planit Strategjik për Biodiversitetin dhe Synimet e Biodiversitetit nga Aichi.

Informatat plotësuese mbi KDB dhe rezultatet e mbledhjes të KP-11 mund t'i gjeni në ueb faqen zyrtare të KDB: <http://www.cbd.int/convention/>

**SI MUNDË TË NDIHMOJMË NË MBROJTJEN E MJEDISIT?**



Udhëto gjelbër. Përdor biçikletën, transportin publik ose ndaje udhëtimin me të tjerët.



Kontribuo në mënyrë vullnetare në aksionet për mbrojtjen e mjedisit ose bëhu pjesë aktive e iniciativave të gjelbra.



## KOSOVA NË RAPORTIN PËR RRJEDHËN E TË DHËNAVE NË AGJENCINË EVROPIANE TË MJEDISIT

Eionet priority data flows  
May 2011-April 2012  
EION 1001770



European Environment Agency

Agjencia Evropiane e Mjedisit ka publikuar raportin mbi rrjedhën e të dhënave prioritare në Rrjetin Evropian të Vëzhgimit dhe Informimit Mjedisor për periudhën 2011-2012. Për herë të parë në historinë e Agjencisë Evropiane të Mjedisit është bërë vlerësimi edhe për rrjedhën e të dhënave prioritare për

Kosovën. Vlerësimi i rrjedhës së të dhënave është bërë për 13 tema nga të cilat 5 nuk kanë qenë relevante për Kosovën. Të dhënat e raportuara nga Kosova përmes Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, janë vlerësuar me pikë maksimale në temat: zonat e mbrojtura të natyrës dhe kualiteti i ujërave të lumenjve, ndërsa kanë marrë vlerësim të mirë edhe për kualitetin e ujërave nëntokësore, emisionet në ajër dhe për ozonin. Në ranglistën e përgjithshme të vendeve e cila përfshin të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet bashkëpunëtoresh (Kroacia, Serbia, Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia), Kosova renditet më lartë se Malta, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi. Ky është Raporti i 15-të me radhë në këtë temë dhe qëllimi i tij është të vlerësojë pro-

gresin e arritur në rrjedhën e të dhënave, të identifikojë problemet që kanë vendet me rrjedhën e të dhënave si dhe të inkurajojë ato për performanca më të mira. Sigurimi i cilësisë së lartë të të dhënave në Rrjetin Evropian të Vëzhgimit dhe Informimit Mjedisor-EIONET është një nga objektivat themelore të Agjencisë Evropiane të Mjedisit. Për të arritur këtë qëllim ajo synon që këto të dhëna të sigurohen me kohë, të jenë relevante dhe të besueshme. Pjesëmarrja e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në aktivitetet e Agjencisë Evropiane të Mjedisit është mundësuar në kuadër të projektit të IPA-s "Pjesëmarrja e Vendeve të Ballkanit Perëndimor në punën e EEA". Kosova është kyçur në këtë projekt në vitin 2010, për të vazhduar me fazën e dytë që ka filluar në fillim të këtij viti dhe do të vazhdojë deri në fund të vitit 2013.

## PROGEO-KOSOVA ANËTARE E PROGEO-EVROPA



ProGEO-Kosova është bërë anëtare e Këshillit të Përgjithshëm të Asamblesë së ProGEO Evropë, Asociacion ky që merret me konservimin e trashëgimisë gjeologjike në Evropë. Në simpoziumin e 7-të të këtij asociacioni të mbajtur në Bari të Italisë, me datë 24-28 shtator 2012, ProGEO Kosova përmes përfaqësuesit të saj është pranuar në Këshillin e Përgjithshëm të Asamblesë së ProGEO

Evropa me të drejta të barabarta me gjithë anëtarët e tjerë nga vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian.

ProGEO-Kosova e themeluar në vitin 2010, është shoqatë jo fitimprurëse, që merret me mbrojtjen dhe konservimin e gjeotrashëgimisë në Kosovë. Që nga themelimi i saj, ProGEO-Kosova në bashkëpunim me ProGEO-Albania ka organizuar disa aktivitete të

përbashkëta si Geotrip 2010 në Grykën e Valbonës, Geotrip 2011 në Bjeshkët e Nemuna dhe Geotrip 2012 në Malin e Krujës. Po ashtu ProGEO – Kosova ka botuar monografinë për Shpellat e Kosovës dhe është duke përgatitur informacionin gjeologjik të gjeomonumenteve dhe gjeoparqeve të Kosovës.

Në kuadër të shoqatës ProGEO-Kosova veprojnë ekspertë të profileve të ndryshëm si: gjeografë, gjeologë, arkeologë e biologë. Shoqata ka bashkëpunim të mirë me: Ministrin e Mjedisit edhe Planifikimit Hapësinor, Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Departamentin e Gjeografisë dhe Gjeologjisë në Universitetin e Prishtinës, Institutin për Hulumtime Karstike të Sllovenisë, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, ProGEO-Albania si dhe me shumë shoqata mjedisore vendore dhe ndërkombëtare. [www.progeo.se](http://www.progeo.se)

KALENDARI  
MJEDISOR

2 SHKURTI  
Dita Botërore e  
Kënetave

22 MARS  
Dita Botërore e Ujit

23 MARS  
Dita Botërore e  
Meteorologjisë

26 MARS  
Ora e Tokës

7 PRILLI  
Dita Botërore e  
Shëndetit

22 PRILLI  
Dita e Tokës

5 QERSHORI  
Dita Botërore e  
Mjedisit



Ky buletin botohet në bashkëpunim mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues:  
Afrim Berisha (MMPH),  
Sami Behrami (MMPH),  
Shkipe Deda-Gjurgjiali (UNDP)  
& Burbuqe Dobranja (UNDP).

Për numrin e radhës abonohu në:  
[www.ks.undp.org](http://www.ks.undp.org)

Versioni online në:  
<http://www.kosovo.undp.org/?cid=2,176>  
Dhe  
[www.ammk-rks.net](http://www.ammk-rks.net)

## UJI SI BURIM I KONFLIKTIT


Edhe pse ende në aspekt global nuk ka krizë të ujit, trendet e konsumit, ndotjes, përdorimit jo racional në shumë regjione të botës kanë shkaktuar jo vetëm krizë por edhe konflikte rreth shfrytëzimit të ujërave. Rreziku më i madh nga konfliktet për resurset ujore është në zonat ku resurset e njëjta ndahen nga dy e më shumë shtete edhe pse me shumë akte dhe rregullore ndërkombëtare është rregulluar mënyra e shfrytëzimit të ujërave nga të gjitha shtetet në të cilat kalojnë lumenjtë. Sipas te dhënave të UNESCO në 50 vitet e fundit kanë ndodhur 1831 incidente në lidhje me ujin, prej të cilave 1228 janë zgjidhur me marrëveshje. Kombet e Bashkuara kanë evidentuar 70 zona në botë me potencial të lartë për konflikte që si faktor kryesor do të kenë ujin, numri

më i madh i të cilave ndodhen në kontinentin e Afrikës, në kontinentin ku më shumë shtete ndajnë ndonjë lum ose liqen. Gjatë shekullit XX, Water Conflict Chronology ka evidentuar 66 konflikte në lidhje me ujërat: 6 në Amerikën Veriore, 14 në Evropë, 23 në Azi, 18 në Afrikë, 4 në Amerikën Jugore dhe 1 në Australi. Në periudhën 1991-2000 nga 31 konflikte për ujin 7 ishin sulme terroriste, kurse nga 11 të periudhës 2001-2002, sulme terroriste ishin 7. Uji është bazë për ekzistencën e shoqërisë njerëzore dhe qenieve tjera të gjalla. Për përmirësimin e gjendjes së tanishme është i nevojshëm shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve ujore. Nëse shoqëria njerëzore në një periudhë të shkurtë kohore nuk ndërmer hapa konkrete në mbrojtjen dhe shfrytëzimin



racional të ujërave, atëherë ujërat do të jenë problem shoqëror, ekologjik, i sigurisë dhe burim i krizave, incidenteve dhe luftërave. "Derisa shumë luftëra në shekullin 20 janë zhvilluar për shkak të naftës, luftërat e shekullit 21 do të ndodhin për shkak të ujit", kështu kishte vlerësuar në vitin 1995 nënkryetari i Bankës Botërore, Ismail Serageldin.

## TË DHËNA TË REJA PËR BIODIVERSITETIN E GLOBIT



Pjesa më e madhe e llojeve të botës janë ende të panjohura për shkencën edhe pse shumë studiues përpiqen të adresojnë pyetjen se sa lloje kanë ekzistuar në Tokë në deka-

dat e fundit. Përllogaritjet e diversitetit jo-mikrobik në Tokë të mundësuar nga studiuesit ndryshojnë nga 2 deri në 50 milionë lloje, me një pasiguri të madhe në shifrat e insekteve, kërpudhave, nematodeve, dhe organizmave të thellësisë së detit. Disa grupe llojesh, të tilla si bimët dhe shpendët, janë të mirënjohura, sipas zbulimeve të pak llojeve të reja çdo vit nga shkencëtarët. Për insektet dhe kërpudhat, megjithatë, është pothuajse e pamundur të supozosh se sa lloje të panjohura ekzistojnë.

Këto rezultate u shpallën në një studim të parë të llojit të vet nga studiuesit e Universitetit Kombëtar të Singaporit (NUS), Universitetit James Cook në Australi, Microsoft Research në Mbretërinë e Bashkuar dhe Universitetit Duke në SHBA. Studiuesit theksuan rëndësinë e teknologjisë si kodi i ADN-së, bazat e të dhënave të reja që mund të përshejtojnë në masë shkallën e zbulimit të llojeve. <http://www.sciencedaily.com/releases/2012/07/120717084802.htm>

## SI MUND TË NDIHMOJMË NË MBROJTJEN E MJEDISIT?



☺ Pasijet elektrike në gjendje gatishmërie shpenzojnë energji kot. Fikni tërësisht ato kur nuk janë në përdorim.



☺ Fikni të gjitha dritat kur dilni nga shtëpia ose kur nuk ju duhen.

TURN OFF LIGHT

